

## **EVIS ÇELA**



Audituese e Lartë, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH

Lindur në vitin 1986. Diplomuar në Ekonomi, dega Financë(2008). Master për Studimet Ekonomike Europiane dhe ACCA(në proces).

6 vite eksperiencë pune dhe të 6 vitet në KLSH. Audituese e Lartë nga muaji mars 2013.

Fusha e ekspertizës: Auditimi i Financave Publike.

### **INSTITUCIONET SUPREME TE AUDITIMIT DHE SFIDAT E TYRE..iiiiii**

*-Rezultatet e Konferencës YOUNG EUROSAI dhe rruga drejt inovacionit-*

*nga Evis Çela*

Për herë të parë këtë vit, EUROSAI organizoi në Hollandë konferencën YOUNG EUROSAI ku morën pjesë auditues të rinj nga të gjithë vendet anëtare të INTOSAI-t. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga znj.Evis Çela, Audituese e Lartë në Departamentin e Auditimit të Performancës.

Përgatitjet për këtë konferencë kanë filluar disa muaj më parë dhe nga Institucionet Supreme të Auditimit u kërkua pjesëmarrja e audituesve të rinj, me kriter të përcaktuar moshën e tyre nën 35 vjeç. Të gjithë personat e caktuar për të marrë pjesë, duhet të jepnin kontributin e tyre me ide apo opinione për mënyrën se si duhej organizuar më së miri kjo konferencë. Gjithashtu, duke qenë se konferenca do të përbëhej nga disa workshop-e të një natyre inovative, kërkohet nga secili vend anëtar i INTOSAI-t opinioni për fushën që duhet të përfshihej në diskutime. Gjatë fazës së parë përgatitore të konferencës, secilit prej nesh ju kërkua të paraqiste disa nga inovacionet apo risitë që institucioni përkatës ka pasur vitet e fundit. Ne si

KLSH, menduam të paraqesim si risi tonën bashkëpunimin e institucionit me organizatat e shoqërisë civile, përfshirjen e tyre si përcjellës të mendimeve të qytetarëve apo kontributin që mund të sjellin me propozimin e temave të auditimit dhe ofrimin e njohurive apo ekspertizës së tyre në fusha specifike. Kjo temë u përzgjedh nga organizatorët si pjesë e diskutimeve në njërin nga workshop-et e organizuara.

Fokusi i kësaj konference ishte procesi i inovacionit, domosdoshmëria dhe rëndësia e tij për Institucionet Supreme të Auditimit. Rezultatet e saj do të përdoren si inpute për kongresin e ardhshëm EUROSAI që do të zhvillohet në qershor 2014, i cili gjithashtu do të ketë si temë qendrore inovacionin.

Young EUROSAI ishte një konferencë ndryshe nga të tjerat, e mbushur me elementë inovativë, në përputhje me misionin dhe fokusin që kishte përcaktuar që në fillim të krijimit të saj. Konferenca u zhvillua në sallën e madhe të Universitetit të Transportit dhe Logjistikës në Rotterdam.

Në këtë konferencë, ndër të tjera, u trajtuan temat e mëposhtme nëpërmjet workshop-eve:

1. *Metodat e auditimit të performancës*, ku një audituese nga Gjykata Europiane të Llogarive bëri një prezantim të shkurtër rreth metodave që përdoren në këtë institucion kryesisht për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Një nga idetë kryesore të këtij workshop-i, ishte se shumë shpesh audituesit e performancës, ndryshe nga audituesit financiarë, ndeshen me vështirësinë e mungesës së të dhënave për këtë lloj auditimi. Për këtë arsye, *Institucionet Supreme të Auditimit duhet të nxisin qeverinë dhe institucionet publike për të ruajtur të dhëna të vlefshme dhe për ti strukturuar ato në mënyrën më të mirë të mundshme.*

2. *Përmirësime në auditimin e performancës*, ku një audituese nga Zyra e Auditimit të Islandës paraqiti risitë e auditimit të performancës në këtë

institucion. Raportet e tyre të performancës vitet e fundit ishin reduktuar ndjeshëm si volum faqesh duke arritur në maksimumi 25-30 faqe. Ky institucion në disa raste publikonte raporte auditimi të përbërë nga *një* faqe e vetme, në të cilën paraqiten vetëm konkluzionet kryesore të auditimit. Kjo qasje nxiste fokusimin e punës audituese në një segment të caktuar të temave të përzgjedhura. Psh, në një auditim të kryer prej tyre në lidhje me cilësinë e shërbimit shëndetësor, nga të gjithë elementët ku mund të fokusoheshin për ta matur atë, ata kishin përzgjedhur kohën që një pacienti i duhet të presë kur shkon për të marrë ndihmën mjekësore.

3. *Të ndjekësh paranë*, ku një nga audituesit e Gjykatës së Llogarive të Hollandës bëri një prezantim të shkurtër rreth “*open spending*”, pra publikimit të transaksioneve financiare për publikun. Gjykata e Llogarive e Hollandës, pas një periudhe përgatitore prej dy vjetësh, kishte filluar procesin e hapjes së të dhënave financiare dhe në vitin 2014 planifikonte të publikonte online të gjitha transaksionet financiare të kryera gjatë vitit të mëparshëm, duke promovuar kështu transparencën dhe duke nxitur nëpërmjet shembullit të tyre edhe institucionet e tjera publike të bëjnë të njëjtin gjë. Në këtë drejtim, ata kishin vendosur një nivel të caktuar privatësie, si p.sh në rastet e udhëtimeve për punë jashtë vendit, vendosnin “udhëtim pune auditues” pa përcaktuar emrin konkret të personit në fjalë.

4. *Të ndërtosh marrëdhënie të suksesshme partneriteti*, është pikërisht tema e propozuar nga KLSH në fazën përgatitore të konferencës dhe që u përzgjedh si fokus i një workshop-i. Një nga audituesit e Gjykatës së Llogarive të Hollandës solli shembullin e tij të bashkëpunimit me kolegë në vendet e tjera Europiane në kuadër të auditimit të NATO-s si dhe me organizata të shoqërisë civile në punën e përditshme të institucionit që përfaqësonte. Në këtë kuadër, gjatë diskutimeve u prezantua edhe puna e madhe që institucioni

ynë ka bërë për tu afruar me qytetarët si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit që janë nënshkruar. *KLSH u vlerësua si shembull i mirë për tu ndjekur në drejtim të bashkëpunimit me universitetet, organizatat e shoqërisë civile, SAI-t e tjerë në rajon dhe më gjerë.* U konsiderua me interes dhe një veprim i zgjuar edhe shkëmbimi i audituesve midis Shqipërisë dhe Kosovës për të përfituar nga trajnimet e përbashkëta të njëri tjetrit, duke shfrytëzuar gjuhën tonë të përbashkët.

Nëpërmjet “brain storming” në këtë konferencë u identifikuan sfidat më të rëndësishme me të cilat përballen sot Institucionet Supreme të Auditimit dhe zgjidhjet ndaj tyre:

Sfidat	Zgjidhjet
<b>Përdorimi i formave të ndryshme të mediave dhe rrjeteve sociale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-publikimi i konkluzioneve të shkurtra me maksimumi 140 shkronja</li> <li>-përdorimi i forumeve të diskutimit në internet për të shpërndarë</li> <li>-mesazhet “dëgjimi“ i twitter-it dhe facebook-ut për sa i takon risqeve të auditimit</li> <li>-mbledhja e propozimeve të qytetarëve nëpërmjet këtyre rrjeteve</li> </ul>
<b>Kultura “zero gabime” është një barrierë për inovacionin</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-institucionet duhet të jenë të hapur ndaj iniciativave që ndërmarrin punonjësit</li> <li>-SAI-t duhet të mësojnë prej gabimeve e jo ti ndëshkojnë ato</li> <li>-SAI-t duhet të nxisin bashkëpunimin dhe peer review ndërmjet njëri tjetrit.</li> </ul>
<b>Të bëhemi më tepër</b>	-institucionet duhet të kuptojnë që ka ardhur koha për të

<b>inovativë</b>	ndryshuar e për të qenë inovativë -ata duhet të bashkëpunojnë me partnerët dhe palët e tyre të interesit
<b>Bashkëpunimi në kuadër të globalizimit</b>	-shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit -përdorimi i ideve dhe praktikave më të mira -ofrimi i mundësisë për audituesit e një SAI që të ndjekin një internship në një SAI homolog, me synim ngritjen e kapaciteteve
<b>Menaxhimi i të dhënave “si të dallojmë sinjalin nga zhurma”?</b>	-përdorimi i mjeteve të avancuara të IT -publikimi i të dhënave financiare nëpërmjet “open data” -filtrimi i të dhënave të nevojshme nga ato të panevojshme
<b>Të maksimizojmë outputin me burimet e kufizuara në dispozicion</b>	-SAI në publikimet e tij duhet të mbajë parasysh impaktin në publik -duhet të zgjedhë temat e auditimit bazuar në risk -mund të kombinojë auditimet financiare me ato të performancës për të maksimizuar përdorimin e burimeve.
<b>Si të transmetojmë mesazhin tonë?</b>	-organizimi i një “dite të hapur” për qytetarët -shkrimi i editorialeve në gazeta
<b>Ruajtja e pavarësisë</b>	SAI mund ta ruajë më mirë pavarësinë e tij nëse: -buxheti në dispozicion të një SAI është më i lartë -audituesit ndjehen të mbrojtur dhe të mbështetur gjatë punës së tyre -rriten publikimet e auditimeve në media
<b>Përdorimi më i mirë i raporteve të auditimit</b>	-raportet e auditimit duhet të jenë të shkurtra e koncize -publikimi i tyre në media apo në rrjete sociale, -përkthimi i raporteve në anglisht për ti ndarë ato me kolegët në komunitetin EUROSAI -publikimi online i tyre në mënyrë që të jenë të disponueshëm në çdo kohë për publikun

Në përfundim të konferencës, Presidentja e Gjykatës së Llogarive të Hollandës, znj. Saskia Stuiveling, theksoi se sa e rëndësishme është për

institucionet e auditimit që ta rinovojnë vazhdimisht veten e tyre, në mënyrë që të kenë po atë forcë, pushtet dhe impakt tek palët e tyre të interesit.

---

<sup>i</sup> Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 25 Dhjetor 2013

<sup>ii</sup> Botuar me disa shkurtime nga origjinali.

<sup>iii</sup> Shkrime të tjera të autores (të papërfshira në këtë botim) gjatë vitit 2013:

- Partneriteti Vital SAI (Ekonomia, 26 qershor 2013)
- Kontrolli i Larte i Shtetit nënkruan marrëveshje me SAI-it e Malit të Zi dhe Hercegovinën (Ekonomia 25 korrik 2013)